



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Forma: Dërguar Punë: Prodato Review: Delivered	13.12.2022	viti god year	
Organ: Njësia Org. Jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHCK	8019/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1019/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1019/2022 të datës 17.11.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ nga _____ kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 13.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet ankesa me numër A.nr.1019/2022 e datës 17.11.2022 e parashtruar nga ankuesi _____ si e pabazuar.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Komunën e Gjakovës, përmes postës më datë 14.11.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 17.11.2022 dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.1019/2022, kundër përgjigjes në kërkesë me numër reference 01-120/01-25818 të datës 11.11.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Gjakovës. Ndërsa Këshilli, me datë 29.11.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7192/2022 të datës 17.11.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë me numër Referencës: 01-120/01-25818 të datës 11.11.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës; Akt Emërimit AE.Nr.01-112/02-37550 të datës 14.12.2021 për ankuesin; Ndryshim dhe Plotësimi i Akt Emërimit e datës 08.07.2019 për _____ Akt Emërimit e datës 31.12.2012 për _____ Zarfin e _____



datës 14.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.11.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 29.11.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për Drejtor i Qendrës për Punë Sociale i datës 27.05.2019; Kërkesën për harmonizimin e koeficientit me numër protokollit 02-120/01-25818 e datës 11.11.2022 e ankuesit; Listën e pagave për ankuesin shtator dhe tetor 2022; Emailin e datës 19.09.2022 nga [] për [] Emailin e datës 30.09.2022 nga [] për [] Emailin e datës 03.10.2022 nga [] për [] dhe Emailin e datës 04.10.2022 nga [] për [] dhe shkresën me numër DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 20.11.2014

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit AE.Nr.01-112/02-37550 të datës 14.12.2021 është i punësuar në pozitë *Drejtor i Qendrës për Punë Sociale* në Komunën e Gjakovës me koeficient të pagës tetë pikë pesë (8.5). I njëjti më datë 11.11.2022 ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 01-120/01-25818 për harmonizimin e koeficientit, ndërsa Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës në përgjigje të kërkesës se ankueses përmes shkresës me numër reference 01-120/01-25818 ka njoftuar ankuesin se: *“sa i përket buxhetit të vitit 2022 është e pamundur të aprovohet kërkesën tuaj”*.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që institucioni duhet ti bëjë harmonizimin e koeficientit në raport të njëjtë me pozitën e njëjtë që mbajnë nëpunësit në komunat e tjera të Republikës së Kosovës, duke kërkuar që ti harmonizohet koeficientit nga tetë pikë pesë (8.5) në dhjetë (10).

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 33 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *“Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë”*, si dhe Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku me nenin 4 është përcaktuar se: *“Kategoritë e pozitave në shërbimin civil 1. Në pajtim me Ligjin, pozitat e punës në shërbimin civil të Kosovës ndahen në këto kategori funksionale: 1.1. Kategoria e Lartë Drejtuese; 1.2. Kategoria e Mesme Drejtuese; 1.3. Kategoria e Ulët Drejtuese, dhe 1.4. Kategoria Profesionale”*, ndërsa sipas nenit 12 të kësaj rregulloreje është përcaktuar se: *“Drejtues i Ulët 2 1. Udhëheqës i Divizionit në një Agjenci Ekzekutive; 2. Udhëheqës i Sektorit në një Komunë”*, andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji ka konstatuar se pozita Drejtor i Qendrës për Punë Sociale është e barasvlershme me pozitën Udhëheqës i Sektorit dhe hyn në kategorinë drejtues i ulët 2, fakt i përcaktuar edhe me Akt Emërimit AE.Nr.01-112/02-37550 të datës 14.12.2022.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, më datë 19.09.2022 dhe 03.10.2022 i është drejtuar me shkresë Departamentit për Menaxhimin e Zyrarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë dhe funksionarëve publikë, duke kërkuar informacione në lidhje me koeficientin e pagës për titullin e punës *Shef i Zyrës në komunë*, Kjo e fundit duke u përgjigjur në kërkesë, më datë 04.10.2022 ka njoftuar se në bazë të Shtojcës Nr.1/7 të Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për



Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, kjo pozitë është e barasvlershme me Udhëheqësin e Divizionit (Sektorin) në Agjenci Ekzekutive dhe se edhe katalogu i vendeve të punës ka përcaktuar pozitën Udhëheqës i Sektorit... Drejtues i Ulët 2 , koeficienti i pagës është 8.5.

Kolegji i Këshillit, po ashtu, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar edhe provat tjera materiale të lëndës, respektivisht shkresën me numër DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 20.11.2014 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil/MAP, përmes të cilës shkresë DASHC kishte kërkuar nga udhëheqësit e organizatave buxhetore që të harmonizohet koeficienti i pagës për disa pozita të punës, ku ndër të tjera është kërkuar që koeficienti i pagës për pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit* të vendoset koeficienti i pagës tetë pikë pesë (8.5).

Andaj, nisur nga konstatimi se ankuesi mban pozitën e punës *Drejtor i Qendrës për Punë Sociale*, pozitë kjo ekuivalente me pozitën e *Udhëheqësit të Sektorit*, e për të cilat pozita organi përgjegjës për administrimin e Shërbimit Civil (DASHC) kishte vendosur koeficientin e pagës tetë pikë pesë (8.5), dhe në kuptim të dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil.* 2. *Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesi për harmonizimin e koeficientit të pagës nga tetë pikë pesë (8.5) në dhjetë (10) nuk ka mbështetje në aktet ligjore dhe nënligjore me të cilat rregullohet çështja e pagave të zyrtarëve publikë, ashtu sikurse nuk ka mbështetje as në politikat e nënshkruara nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, si organ përgjegjës për administrimin e Shërbimit Civil në Republikën e Kosovës, dhe në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se nuk ka ndonjë lloj diskriminimi në raport me ankuesin.

Andaj, për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1019/2022

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesi
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.